



Dalës-izlazna

Nr. -1-04
Br.

Data 17.01.2023
Datum



Republika e Kosovës - Republika Kosovo - Republic of Kosovo
Kuvendi Komunal Obiliq - Skupština Opština Obiliq - Municipality Assembly Obiliq

EKSTRAKTI PROCESVERBALIT

Nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, të mbajtur me dt.23.12.2022, në orën 10:00, në sallën e Kuvendit komunal.

Të pranishëm ishin: Vlora Mjekiqi Kabashi, Enver Gashi, Labinot Mirena, Ajshe Haliti Pllana, Sami Ahmeti, Bajram Hashani dhe Nazlije Shala

Të pranishmit tjerë: drejtorët komunal, Festina Preniqi, zyrtare për marrëdhënie me publikun, Fatime Pllana nga DAK, Hamit Mjeku, shef i DSHPE-së, Burim Gërguri, shef i kabinetit të Kryetarit

Mbledhjen e udhëhoqi Vlora Mjekiqi Kabashi, kryesuese e cila pasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

REND DITE

1. Arsyetimi për mungesë
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Shqyrtimi i Propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës për nismën e bashkëpunimit ndërkomunal
4. Shqyrtimi i Propozim Vendimit nr.-II-1721, i dt.09.12.2022, për miratim paraprak të Listës së përgjithshme të pronës së paluajtshme të Komunës dhe Listën e veçantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënie në shfrytëzim afatgjatë për vitin vijues 2023
5. Diskutimi i Raportit të Performancës të Komunës së Obiliqit për vitin 2021
6. Dhënia e pëlqimit për diskutim publik të Kodit Etik për zyrtarët e Komunës së Obiliqit
7. Shqyrtimi i kërkesës nr.-III-392, të dt.16.12.2022, për aprovimin e Planit Komunal të Integritetit për vitin 2023-2026
8. Shqyrtimi i raportit për plotësim ndryshimin e Rregullores për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale sipas rekomandimeve të Ministrisë së linjave
9. Shqyrtimi i kërkesave
10. Të ndryshme

Kryesuesja – I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës, i cili u miratua me 7 vota për.

Pika 1 e rendit të ditës

Të gjithë anëtarët ishin të pranishëm.

Pika 2 e rendit të ditës

Miratohet ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar me 5 vota për dhe 2 vota abstenim.

Pika 3 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqet shqyrtimin e Propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës për nismën e bashkëpunimit ndërkomunal.

Enver Gashi – Ne jemi për atë që ky Propozim Vendim të kalojë në Kuvend dhe atje do ta japim kontributin tonë.

Sami Ahmeti – Kjo nismë, ose kërkesë për autorizim për Kryetarin që të bisedoj dhe ta bëjë këtë marrëveshje, neve po na duket se është bashkëpunim mbi bashkëpunim, pasi që ne kemi Asociacionin e

Komunave të Kosovës, që i mbulon të gjitha këto fusha. Megjithatë, kur është çështja për bashkëpunim mendoj se nuk ka asgjë të keqe që edhe ne jemi për atë që këtë Propozim Vendim të Kryetarit të Komunës ta rekomandojmë për mbledhjen e Kuvendit komunal.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me 7 vota për ia rekomanduan Kuvendit shqyrtimin dhe aprovimin e Propozim Vendimit të Kryetarit të Komunës

Pika 4 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqet shqyrtimin e Propozim Vendimit nr.-II-1721, i dt.09.12.2022, për miratim paraprak të Listës së përgjithshme të pronës së paluajtshme të Komunës dhe Listën e veqantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për vitin vijues 2023.

Arben Berisha – Ne përmes zyres së Kryetarit kemi kërkuar sipas ligjit në fuqi dhe Udhëzimit administrativ që e përcakton në vitin paraprak të shpallet Lista për dhënien në shfrytëzim të parcelave. Ne punën e kemi organizue, por vetëm një gabim na ka ndodhë që kërkoj mirëkuptim sepse një parcelë na ka ikë që Komisioni nuk e ka publikue. Mirëpo, për mbledhjen e Kuvendit do ta sjellim me nënshkrim të Komisionit. Parcela është në zonën kadastrale Obiliq dhe kërkojmë mirëkuptim që të përfshihet në listën e dhënies në shfrytëzim.

Enver Gashi – Ne jemi për atë që propozimin që e dha drejtori të shkoj në Kuvend për shqyrtim dhe aprovim.

Sami Ahmeti – Ne nuk jemi kundër miratimit të Listave të pronave, edhe pse shpesh e kemi thënë që kur është çështja te pronat kemi vërejtjet dhe dyshimet tona, aq më tepër kur bëhet fjalë për rritjen e vlerës së pronave komunale, gjithsesi që do të duhej të ishte diçka e mirë. Ajo çka jemi kundër është edhe fraza që ceket edhe në kërkesën për këtë miratim të këtij propozimi është dhënia në afat të gjatë e pronave publike. Dihet se ligji e lejon dhënien e pronës edhe në afat më të shkurtë për të pa fillimisht nëse ai biznes, ose ai operatorë që zhvillon aktivitetin e tij është i suksesshëm, apo jo. Edhe pse në vitin paraprak duhet të jepen pronat për vitin e ardhshëm, ne mendojmë se kjo çështja e pronave është shumë e dyshimtë dhe në këtë pikë ne abstenojmë.

Arben Berisha – Sqaron për parafolësin se dhënia e pronave afatshkurtë bëhet përmes Komisionit dhe kjo është tjetër, ndërsa ajo që ky po pretendon është diçka tjetër. Mirëpo, ligji e parashehë kështu dhe në bazë të ligjit dhe Udhëzimit administrativ, ne e kemi përgatitë listën, ndërsa sa i përket dyshimeve ajo është çështje personale.

Kryesuesja – E lus drejtorin që të na sjellë materialin për parcelën shtesë në mënyrë që të jetë e gatshme për mbledhjen e Kuvendit komunal.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 5 vota për dhe 2 vota abstenim ia rekomanduan Kuvendit Komunal shqyrtimin e Propozim Vendimit nr.-II-1721, i dt.09.12.2022, për miratim paraprak të Listës së përgjithshme të pronës së paluajtshme të Komunës dhe Listën e veqantë të pronave të paluajtshme të Komunës që planifikohen për dhënien në shfrytëzim afatgjatë për vitin vijues 2023.

Pika 5 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqet kërkesën për diskutimin e raportit të performancës të Komunës së Obiliqit për vitin 2021.

Enver Gashi – Ne nuk kemi me shtue asgjë, por ia rekomandojmë Kuvendit komunal.

Sami Ahmeti – Pasi që ky është obligim ligjor nuk kemi asgjë kundër që ky raport i performancës për vitin 2021 edhe pse konsiderojmë se nuk ka kurrfarë relevance apo rëndësie sepse po flitet për vitin 2021, të shkoj dhe të bisedohet. Ndërsa, kur është çështja për obligimet ligjore në pikën të ndryshme, unë do ti japë disa propozime që po ashtu janë obligime ligjore. Gjithsesi jemi për që të diskutohet në Kuvendin komunal.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me 7 vota për ia rekomanduan Kuvendit komunal diskutimin e Raportit të Performancës të Komunës së Obiliqit për vitin 2021.

Pika 6 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqet kërkesën për dhënien e pëlqimit për diskutim publik të Kodit Etik, për zyrtarët e Komunës së Obiliqit.

Enver Gashi – Ne jemi për atë që ti rekomandohet Kuvendit komunal dhe kjo veç ka me shkuë në diskutim publik, pastaj prapë kthehet në Kuvend dhe do ta japim kontributin tonë edhe ne si anëtarë të Kuvendit.

Sami Ahmeti – Ne jemi dakord që Kodi etik për zyrtarët e Komunës, ti rekomandohet Kuvendit komunal, që të dalë në debat publik sepse konsiderojmë se bash për Komunën e Obiliqit, ky kod është shumë i rëndësishëm, kuptohet për zyrtarët e saj, por edhe për qytetarët e Obiliqit.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për ia rekomandojnë Kuvendit Komunal dhënien e pëlqimit për diskutim publik të Kodit Etik për zyrtarët e Komunës së Obiliqit.

Pika 7 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqet shqyrtimin e kërkesës nr.-III-392, të dt.16.12.2022, për aprovimin e Planit komunal të Integritetit për vitin 2023-2026.

Enver Gashi – Ne jemi për atë që këtë plan të ia rekomandojmë Kuvendit komunal.

Sami Ahmeti – Ne e kemi dhënë pëlqimin për planin e integritetit që të dalë në debat publik dhe gjithsesi jemi që të bisedohet në seancën e Kuvendit komunal dhe atje shpresojmë të japim kontributin tonë.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për ia rekomandojnë Kuvendit Komunal shqyrtimin e kërkesës nr.-III-392, të dt.16.12.2022, për aprovimin e Planit komunal të Integritetit për vitin 2023-2026.

Pika 8 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqet shqyrtimin e raportit për ndryshim plotësimin e Rregullores për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale në Komunën e Obiliqit sipas rekomandimeve të Ministrive të linjave.

Enver Gashi – Ne jemi për që ky ndryshim dhe plotësim i Rregullores ti rekomandohet Kuvendit komunal dhe Komisioni ti arsyetoj vërejtjet e ardhura nga Ministrinë e linjave, në mënyrë që më mos të përsëriten.

Sami Ahmeti – Në fakt ky është një raport i përmbledhjes së krejtë Ministrive, që e kanë kthye ku ka pasë ndeshje ligjore, do të thotë ku ka pasë mospërputhshmëri ligjore. Të kuptojmë se Komisionet nuk janë të gjithanshme, aq më tepër kur të njejtat Komisione shumë shpesh vendosen në shumë lëmi dhe ky nuk është raport, por është kërkesë për ndryshim të Rregullores që e kemi bërë në tetor të këtij viti. Pra, nuk është diçka e re, por kjo shumë shpesh ndodhë, kështu që le të shkoj në Kuvend dhe atje bisedojmë.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për ia rekomanduan Kuvendit komunal shqyrtimin e raportit për ndryshim plotësimin e Rregullores për Tarifa, Ngarkesa dhe Gjoha Komunale në Komunën e Obiliqit sipas rekomandimeve të Ministrive të linjave.

Pika 9 e rendit të ditës

Kryesuesja – Të nderuar anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa, kërkoj nga ju formimin e Komisionit për planin e punës të Kuvendit komunal për vitin 2023. Nëse, jeni dakord që ky Komision ti ketë 5 anëtarë, ku një anëtarë duhet të jetë i jashtëm nga një OJQ.

Enver Gashi – Ne jemi për që të shkoj në Kuvend formimi i këtij Komisioni.

Sami Ahmeti – Edhe ne jemi për atë që ti rekomandojmë Kuvendit komunal.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për ia rekomanduan Kuvendit Komunal formimin e Komisionit për hartimin e Planit të Punës të Kuvendit komunal për vitin 2023.

Pika 10 e rendit të ditës

Enver Gashi – Propozoj që në Kuvend të shqyrtohet blerja e llap topëve për anëtarët e Kuvendit komunal. Ne anëtarët e vjetër të Kuvendit veç i kemi llap topët, por mendoj se Kuvendi duhet të marrë vendim për këtë çështje.

Sami Ahmeti – Më duket se kjo është vetëm sa për me na tregue që kontrata është bërë për çështjen e llap topëve. Thuhet se është bërë një kontratë për Kuvendin komunal dhe është dhënë në formën publike në faqen e Komunës dhe për çka është nuk e di, por kam parë se është bërë një kontratë.

Kryesuesja – Unë nuk kam njohuri se është ble diçka për anëtarët e Kuvendit. Unë e kam bërë më heret një kërkesë dhe më është thënë se anëtarët e Kuvendit duhet të marrin vendim nëse, dëshirojnë të pajisen me llap top dhe ai vendim duhet ti dërgohet drejtoreshës së administratës për të vazhduar me procedurat tjera. Ata të cilët kanë qenë anëtarë të Kuvendit edhe në mandatin e kaluar dhe i kanë llap topët, keni bërë një marrëveshje paraprake me administratën që thotë se asetet komunale jeni të obliguar me i kthye. Atëherë, vendosni nëse doni me i mbajtë ata nëse nuk doni me i mbajtë ata jeni të obliguar me i kthye dhe me i marrë të tjerët.

Labinot Mirena – Propozoj që ti kthejmë llap topët e vjetër dhe ti marrim të rinjët.

Pas diskutimeve, anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 7 vota për i rekomanduan Kuvendit Komunal të marrë vendim për furnizimin me llap top për anëtarët e Kuvendit Komunal.

Sami Ahmeti – Duke u bazuar në LVL-në, neni 52 KPF-ja është organ me kompetenca në shqyrtimin e shumë dokumentacioneve dhe politikave, prandaj kërkoj nga Ekzekutivi që të na siguroj planin vjetor të punës për auditim të brendshëm për vitin 2022 si dhe një raport të auditorit për këtë vit. Më duket se e kemi një auditor edhe pse sipas ligjit do të duhej ti kishim më shumë se 2. E dyta, në web faqen e Komunës së Obiliqit janë shpallë 2 kontrata të njejta, të dyja bashkëfinansim me MAPL-në për projektin e rehabilitimit të infrastrukturës për komunitetet rom, ashkali dhe egjiptian në Plemetin. Njërsa mban datën 9.9.2022, ndërsa tjetra 25.11.2022, të dyja për projektin e njejtë, njëra me kohëzgjatje 75 ditë, e tjetra 1 vit, edhe çmimin pothuajse e kanë të njejtë. Tani, ne kërkojmë nga Drejtoria përgjegjëse që në seancën e radhës të na ofroj përgjegje se a është shkëputur zyrtarisht kontrata e parë sepse po bëhet fjalë për kontratë të njejtë, a ka kryer operatori ekonomik ndonjë situacion të asaj kontrate, a është bërë ndonjë pagesë për kontratën e parë pasi që është bërë edhe një kontratë mbikontratë për të njejtin projekt dhe si është e mundur që operatori i njejtë ekonomik e mori kontratën e parë dhe të dytë. Gjithsesi, ne do të bëjmë kërkesë me shkrim në formë më të specifikuar në drejtim të Drejtorive, por këto janë pyetje që do të dëshironim që në seancën e ardhshme ti kemi për këtë çështje. E treta, kryesuese në seancën e muajit të kaluar në të ndryshme për me i ndalë disa forma të debateve, jo pse është ky në listë, jo pse është dhënë ky subvencion për udhëtim, jo pse është dhënë kjo bursë për këta studentë, i plotësojnë, nuk i plotësojnë kushtet në kërkovë, pasi që na lejon ligji që në afatet e lejuara me ligj të na caktohet një takim në Drejtorinë e arsimit. Atje ne si grup do të mund ti ceknim vërejtjet tona për ndonjë emër që neve, na ka ardhë si informacion se ka shkelje edhe pse ka kaluar afati ligjor për qasje në dokumente se afati ligjor është 7 ditë në rast të vazhdimit të tij, institucioni e lajmëron kërkuesin që po shtyhet edhe 7 ditë tjera, gjithsejt 15 ditë ka mundësi me u kthye një përgjegje. Në të kundërtën Agjensioni për informim dhe privatësi ka mundësi edhe me denuë institucionin i cili nuk ofron dokumente sepse janë dokumente publike. Deri më tani nuk kam marrë ndonjë përgjegje. Kryesuese, do të ishte mirë që të kemi një bashkëpunim më të mirë, të paktën me juve sepse iu drejtova juve dhe kërkoja që me përcjellë atë pjesë. Unë e kam parë një tendencë se je një përfaqësuese e një subjekti politik, që edhe ne të gjithë jemi dhe të konsiderojmë pak më tepër se përfaqësuesit tjetër të opozitës se je Kryetare edhe e jona. Besoj se është mirë me qenë transparentë edhe me neve sepse edhe në disa raste tjera, e kam parë se ke tendencë me na ndalë fjalën kur është çështja për replika. Unë kisha kërkuar me mirëkuptim që me pasë respekt ashtu qysh po kemi ne respekt ndaj juve.

Kryesuesja – Jo vetëm juve, në fakt jeni ju dhe z.Ajet Berisha, që në vazhdimësi është koha edhe më tepër se sa që është e limituar. Në fakt, më vjen keq është këtu drejtori i DPUKP-së, z.Arben Berisha, por është shumë e vërtetë që drejtorin disa herë e kam largue nga foltorja dhe ia kam ndërprerë fjalën. Unë absolut këtu, jam e njejtë sepse është një ligj dhe një Rregullorë. Sa i përket qasjes në dokumente, unë kam biseduar me zyrtarin z.Adem Haliti, i cili është zyrtari kompetentë për qasje në dokumente dhe i kam kërkuar që me iu thirrë në telefon, me shikue mënyrën dhe rregullën ligjore se çka duhet z.Ahmeti me njoftue që me ardhë dhe me pasë qasje në dokumente. Ai më tha se tash e thërrasë z.Sami Ahmeti dhe bisedoj me të. Unë nuk e kam harrue dhe nuk është që nuk kam folë me të, i kam thënë të lutem njoftoje z.Sami Ahmeti, sepse ka kërkuar qasje në dokumente dhe tregoji në çfarë forme nëse, duhet me shikue edhe me shkrim të lejohet qasja në dokumente.

Sami Ahmeti – Sa i përket kësaj teme, unë prej z.Adem kam marrë një përgjegje vetëm kur e kam thirrë dhe i kam tregue Adem kaloi 15 ditëshi, koha që e keni obligim me na dhënë qasje. Atëherë, më ka thënë hajt se bisedoj nesër me kryesuesen se nuk kam qenë në të ndryshme dhe nuk e kam ditë këtë çështje. Pastaj është çështje e ligjit dhe nuk është çështja pse ngurron kryesuesja, ose ngurron z.Adem sepse nuk kërkoj diçka që nuk më duhet dhe diçka që nuk është e imja. Kjo është çështje ligjore dhe unë e di qysh bëhet kërkesa, që mund të bëhet në formën gojore dhe është kërkuesi ai i cili e cakton formën qysh don me pasë qasje në dokumente, jo në dokumente personale dhe shëndetësore të askujt sepse ato janë personale. Mirëpo, kur është çështje publike, kur është paraja publike ka gjithmonë të drejtë secili qytetarë, e aq më tepër ne si përfaqësues të tyre. Unë tashmë e kam bërë kërkesën te Agjensioni për privatësi dhe informim, që është Agjension mbikqyrës i të gjitha institucioneve të Republikës dhe ata ju dërgojnë një vërejtje, apo një Udhëzim se si funksionon. Afatet ligjore kanë kalue, kështu që është në të drejtën time me bë dhe unë

nuk përtoj shumë me shkruar. Edhe për një çështje tjetër kisha dashtë me biseduar në seancën e ardhshme se kemi pasë disa qytetarë që neve, na janë drejtuar dhe kanë thënë se për çështjen e dëmeve në bujqësi nuk kemi pasë mundësi me aplikuar sepse në Komunë na është thënë se nuk ka mjete për këtë punë edhe pse ato mjete dhe ato aplikime kanë qenë te Qeveria e Republikës, që i ka ndarë ato. Ne kishim pasë dëshirë që në seancën e ardhshme drejtori ose përfaqësuesi i Drejtorisë së bujqësisë, të na informoj sa ka pasë aplikuar dhe mundësisht të na jep listën e personave që kanë aplikuar për subvencion, për dëme në bujqësi.

Kryesuesja – Patjetër z.Ahmeti, sa i përket qasjes në dokumente keni të drejtë dhe unë edhe atë ditë aty për aty ta kam vërtetuar se ligji ta lejon, jo vetëm ty por çdokujt tjetër që ke të drejtë. Ndërsa, për pyetjen që e bërë për bujqësi në mbledhjen e Kuvendit, në pikën të ndryshme drejtori do të përgjigjet.

Mbledhja përfundoi në ora 10:34'

Bashk.prof.për punë të KK


Azize Zeneli

Kryesuesja e KPF


Vlora Mjekiqi Kabashi

